Njohuria procedural. Kjo njohuri lidhet me kuptimin se si kryhen aktivitete ose detyra të caktuara duke ndjekur hapa ose procedura të caktuara. Ajo nuk është vetëm teorike, por ka një komponent praktik të fuqishëm, i rëndësishëm për aplikimin në kontekste të ndryshme. Shpesh lidhet me mësimin praktik dhe aktivitetet që përfshijnë kryerjen manuale (p.sh., përdorimi i veglave në zanate) ose mentale (p.sh., përdorimi i softuerëve për analizë të të dhënave). Njohuria procedurale nuk ka të bëjë vetëm me ndjekjen automatike të hapave – përfshin aftësinë për të përshtatur procedurat në situata të reja (p.sh., kur mësohet si realizohet një projekt në fizikë, të njëjtat hapa mund të përdoren për një projekt në biologji). Ajo kërkon kuptim kognitiv që lejon ndjekjen, analizimin dhe përmirësimin e proceseve. Me kuptimin e procedurave, nxënësit mund të mësojnë teknikë të reja vetë dhe të eksplorojnë fusha të panjohura, gjë që është kryesorë për adaptimin në vendet moderne të punës dhe sfidat e jetës. Njohuria procedurale është aspekti praktik i të mësuarit që u mundëson nxënësve të dinë jo vetëm çfarë (njohuria diziplinore) dhe pse (njohuria epistemike), por edhe si ta zbatojnë këtë njohuri në situata konkrete, duke krijuar bazën për autonomi, inovacion dhe efikasitet në jetën reale.

Tabela 1. Njohurit si kompetenca të cilat duhet t'i përvetësojnë nxënësit deri në fund të arsimit të mesëm

NJOHURI	Nxënësit kanë fituar njohuri të cilat i mundësojnë...
NJOHURI DISIPLINARE	Nj-1 ...ti kuptojnë dhe zbatojnë konceptet themelore që mësohen në lëndët e caktuara mësimore të përfaqësuara në planin mësimor për arsimin e mesëm.
	Nj-2 ...të zgjedhin problem komplekse duke përdorur bazat e disiplinave shkencore dhe teknologjike.
	Nj-3 ...të analizojnë dhe interpretojnë tekstet dhe të dhënat me qëllim të sjellin vendime të bazuara në iformata.
NJOHURI NDËRDISIPLINARE	Nj-4 ...ti kombinojnë njohurit nga disiplina dhe fusha të ndryshme që ti kuptojnë problemet globale.
	Nj-5 ...ti zhvillojnë projekte të cilat i bashkojnë njohurit nga më tepër disiplina me qëllim të propozimit të zgjidhjeve të çështjeve shoqërore.
NJOHURI EPISTEMIKE	Nj-7 ...në mënyrë kritike ti vlerësojnë burimet e informatave dhe ta bëjnë dallimin midis informata të konfirmuara dhe dezinformatave.
	Nj-8 ...të kuptojnë se si metodat shkencore përdoren në profesione të ndryshme dhe si ajo ndikon në zhvillimin e koncepteve në disiplina të ndryshme.
NJOHURI META-KOGNITIVE	Nj-9 ...të vendosin vetë qëllimet e të nxënit dhe të zhvillojnë strategji për vetëkontroll dhe reflektim
	Nj-10 ...të vlerësojnë përparimin e tyre dhe të përshtatin qasjen e të nxënit për të arritur qëllimet.
	Nj-11 ...të kuptojnë rëndësinë e vetëvlerësimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm gjatë procesit të të nxënit.

Aftësitë

Aftësitë u mundësojnë nxënësve të përdorin njohuritë e tyre për të kryer detyra të caktuara, për të zgjidhur probleme dhe për t'u përballur me situata të ndryshme. Aftësitë janë mjete për të aplikuar njohuritë dhe janë thelbësore për adaptim të suksesshëm në kontekstin e ndryshimeve të shpejta në botë.

Njohuritë dhe aftësitë plotësojnë dhe forcojnë njëra-tjetrën. Ato nuk janë kompetenca të izoluar – funksionojnë së bashku për të mundësuar jo vetëm përvetësimin e njohurive, por edhe përdorimin e tyre në përballje me detyra komplekse, adaptim në kontekste të ndryshme dhe kuptim të botës përreth nesh. Njohuritë sigurojnë bazën teorike dhe kuptimin e nevojshëm për aplikimin e aftësive. Aftësitë janë ato që e mundësojnë përdorimin praktik të njohurive të fituara në kontekste të ndryshme. Në këtë mënyrë, përmes zhvillimit të aftësive, gjithashtu kontribuohet në thellimin e njohurive.

Tabela 2. Aftësitë si kompetenca që nxënësit duhet t'i arrijnë deri në fund të arsimit të mesëm

AFTËSITË	Nxënësit kanë fituar aftësi që u mundësojnë...
AFTËSITË KOGNITIVE	Af-1 ... të analizojnë dhe vlerësojnë informacionet nga burime të ndryshme dhe të formulojnë argumente logjike.
	Af-2 ... të ofrojnë zgjidhje inovative për probleme komplekse.
	Af-3 ... të gjenerojnë ide të reja, të mendojnë jashtë kornizës dhe të aplikojnë qasje krijuese për zgjidhjen e çështjeve në botën reale.
	Af-4 ... të lëvizin në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme në hapësirën digjitale, të vlerësojnë kritikisht informacionet në internet dhe të aplikojnë mjetet digjitale në kontekste akademike dhe personale.
AFTËSITË PERSONALE DHE SOCIO-EMOCIONALE	Af-5 ... të tejkalojnë sfidat, të përballen me situata stresuese, të përshtaten me rrethanat në ndryshim dhe të qëndrojnë të vendosur në arritjen e qëllimeve, duke mësuar nga dështimet.
	Af-6 ... të vendosin në mënyrë të drejtë dhe etike dhe të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme, duke respektuar normat morale.
	Af-7 ... të kujdesen për shëndetin e tyre fizik dhe mendor përmes një mënyre jetese të shëndetshme dhe menaxhimit të stresit.
	Af-8 ... të tregojnë mirëkuptim dhe respekt për emocionet dhe perspektivat e të tjerëve.
	Af-9 ... të angazhohen në mënyrë aktive në punë në grup dhe të bashkëpunojnë në mënyrë efektive me të tjerët gjatë kryerjes së detyrave grupore dhe arritjes së qëllimeve të përbashkëta.
	Af-10 ... të artikulojnë qartë idetë, të dëgjojnë në mënyrë aktive dhe të angazhohen në dialog duke respektuar të tjerët dhe duke përshtatur stilin e tyre të komunikimit sipas konteksteve të ndryshme.
AFTËSITË FIZIKE DHE PRAKTIKE	Af-11 ... të zbatojnë rutina të shëndetshme për aktivitet fizik të rregullt që përmirëson qëndrueshmërinë, forcën dhe balancën e tyre
	Af-12 ... të menaxhojnë në mënyrë efikase kohën, paratë dhe burimet materiale.
	Af-13 ... të marrin vendime të informuara financiare, të menaxhojnë buxhete dhe të praktikojnë kursim dhe investim për të përmbushur nevojat e ardhshme.
	Af-14 ... të identifikojnë mundësitë për inovacion, të marrin iniciativë dhe të aplikojnë strategji për menaxhim të rrezikut në kontekst personal ose biznesi.
	Af-15 ... të përdorin në mënyrë efektive dhe të sigurtë mjetet dhe teknologjitë në situata praktike të jetës së përditshme dhe në karrierë.

Brenda aftësive bëhet dallimi midis tre llojeve të kompetencave: aftësitë kognitive (aftësia për të menduar, analizuar, zgjidhur probleme dhe për të qenë kreativ), aftësitë personale dhe socio-emocionale (aftësia për vetërregullim, komunikim, bashkëpunim, empati, menaxhim të emocioneve dhe marrëdhënieve me të tjerët) dhe aftësitë fizike dhe praktike (aftësitë motorike, teknike, teknologjike dhe funksionale). Të tre llojet e aftësive përbëjnë një grup të integruar të kapaciteteve që u mundëson nxënësve të bëhen qytetarë kompetentë, adaptues dhe përgjegjës (Tabela 2)

Aftësitë janë të aplikueshme në kontekste dhe situata të ndryshme, që do të thotë se, sapo të merren, mund të përdoren në mësim, punë dhe jetën e përditshme. Ndër to janë edhe aftësitë transversale, si komunikimi dhe mendimi kritik, të dobishme për një gamë të gjerë detyrash dhe profesione. Megjithatë, aftësitë nuk duhet parë si kompetenca fikse, por si objekt i të nxënësve gjatë gjithë jetës. Ndryshimi i pashmangshëm i konteksteve kërkon përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm të aftësive të fituara në arsimin e mesëm.

Në procesin e mëimit, aftësitë zhvillohen përmes përvojës dhe zbatimit aktiv të njohurive të fituara. Mësimi përmes përvojës, që është baza e zhvillimit të aftësive, kërkon që nxënësit të marrin pjesë në aktivitete që u mundësojnë të aplikojnë aftësitë në situata reale. Zhvillimi i aftësive nuk ndodh vetëm përmes aplikimit të njohurive nga një fushë e vetme ose një lëndë. Përkundrazi, pothuajse të gjitha aftësitë fitohen përmes aktiviteteve që zhvillohen në lëndë të ndryshme (p.sh., aftësitë e komunikimit zhvillohen në orët e gjuhës dhe letërsisë, por edhe përmes punës projektuale në shkencat natyrore ose shoqërore).

Procesi arsimor duhet të sigurojë një ekuilibër midis njohurive dhe aftësive, dmth. midis teorisë dhe praktikës. Nëse arsimi fokusohet vetëm në fitimin e njohurive dhe anashkalon zhvillimin e aftësive, nxënësit mund të kenë vështirësi në zbatimin e njohurive. Nga ana tjetër, nëse fokusohet vetëm në aftësi, mund të humbasë thellësia e kuptimit. Prandaj, sistemi arsimor duhet të nxisë mësim të integruar, ku njohuritë dhe aftësitë zhvillohen njëkohësisht, përmes projekteve, kërkimeve dhe zgjidhjes së problemeve reale.

Vlerat dhe qëndrimet

Vlerat janë besime të thella të cilat pasqyrojnë parimet dhe idealet që konsiderohen të rëndësishme dhe të vlefshme. Ato shpesh lidhen me kulturën, fenë dhe normat shoqërore, gjë që i bën relativisht të qëndrueshme. Vlerat përcaktojnë dallimin midis asaj që konsiderohet "e drejtë" dhe "e gabuar" dhe ndikojnë në sjelljen e individëve gjatë gjithë jetës. Për shembull, një person që beson në rëndësinë e ndershmërisë do të respektojë ligjet që nxisin transparencën dhe parandalojnë korrupsionin.

Qasjet janë preferenca, besime ose tendenca individuale që ndikojnë direkt në reagimet dhe vendimet e individëve në situata konkrete. Ato janë më subjektive dhe fleksibile se vlerat, sepse varen nga përvoja personale, njohuritë dhe konteksti. Për shembull: qëndrimi ndaj rëndësisë së punës në grup, qëndrimi pozitiv ose negativ ndaj zhvillimit të inteligjencës artificiale, ose qëndrimi ndaj ngrohjes globale.

Vlerat formojnë bazën mbi të cilën zhvillohen qasjet. Ato udhëheqin përdorimin e qasjeve, duke përcaktuar kontekstin në të cilin zbatohen. Për shembull, një nxënës që vlerëson barazinë zhvillon një qëndrim pozitiv ndaj pranisë të ndryshimeve. Qasjet mund të reflektojnë drejtpërdrejt vlerat, por edhe të ndryshojnë nga ato, veçanërisht kur individ i ekspozohet ndaj përvojave ose informacionit të ri. Në terma të thjeshtë, vlerat janë udhërrëfyes të qëndrueshëm për sjellje dhe vendimmarrje etike, ndërsa qasjet janë orientime më të lëvizshme që ndikojnë në sjelljen e përditshme. Të dy, vlerat dhe

qasjet, luajnë rol kryesorë në përgatitjen e nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm dhe të aftë të adaptohen në situata të reja në mënyrë të përshtatshme.

Lidhja midis njohurive, aftësive, vlerave dhe qasjeve është komplekse dhe e ndërvarur. Këto katër lloje kompetencash janë të lidhura dhe së bashku nxisin zhvillimin personal, profesional dhe shoqëror të nxënësve. Nga njëra anë, vlerat dhe qasjet udhëheqin njohuritë dhe aftësitë duke formësuar mënyrën se si nxënësit i fitojnë dhe i zbatojnë ato. Për shembull, nxënësit me qëndrim pozitiv ndaj bashkëpunimit do të përdorin aftësitë e tyre për punën në grup në drejtim të realizimit të qëllimeve të përbashkëta, jo për përfitim personal. Nga ana tjetër, njohuritë dhe aftësitë mbështesin zbatimin e vlerave dhe qasjeve, duke u mundësuar nxënësve t'i shprehin ato në praktikë. Për shembull, një nxënës që vlerëson drejtësinë do të përdorë aftësitë e tij kognitive për të vlerësuar drejtësinë e rregullave ose politikave të caktuara.

Ndikimi është i dyanshëm: vlerat sigurojnë bazën për mendim dhe veprim etik, duke motivuar përdorimin e njohurive dhe aftësive në përputhje me standardet morale personale dhe shoqërore, ndërsa qasjet ndikojnë në motivimin dhe qasjen ndaj të nxënësve dhe zgjidhjes së problemeve. Njohuritë krijojnë bazën për informim dhe mendim kritik, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë kontekstin ku duhet të zbatojnë vlerat dhe qasjet e tyre, ndërsa aftësitë e mundësojnë këtë zbatim praktikisht.

Në procesin arsimor, vlerat zhvillohen përmes mësimin të përmbajtjeve që nxisin reflektimin mbi vlerat, përmes pjesëmarrjes në diskutime dhe aktivitete grupore, duke vëzhguar sjelljen e mësimdhënësve si shembull, si dhe përmes angazhimit në aktivitete vullnetare dhe shoqërisht të dobishme. Qasjet zhvillohen përmes ekspozimit ndaj perspektivave të ndryshme (p.sh., pjesëmarrje në debate për çështje kontestuese, ekspozim ndaj ideve, feve dhe kulturave të ndryshme), përvojave personale dhe shoqërore, dhe përmes feedback-ut nga bashkëmoshatarët dhe mësimdhënësit mbi ndikimin e qasjeve të tyre në sjellje.

Si përfundim, zhvillimi i vlerave dhe qasjeve është një proces dinamik që kërkon mbështetje të vazhdueshme nga mësimdhënësit dhe komuniteti. Ai realizohet përmes kombinimit të arsimit formal, ndërveprimeve sociale dhe të nxënësve përmes përvojës, duke shërbyer si bazë për sjellje etike, empatike dhe të përgjegjshme në jetën personale dhe profesionale.

Tabela 3. Vlerat dhe qëndrimet si kompetenca të cialt duhet ti fitojnë nxënësit deri në fund të arsimit të mesëm

VLERAT dhe QËNDRIMET	Nxënësit kanë pranuar vlera dhe qëndrime që i nxisin ...
RESPEKTIMI I DALLIMEVE, DREJTËSISË DHE BARAZISË	VQ-1 ... të tregojnë hapje dhe respekt ndaj kulturave, besimeve dhe perspektivave të ndryshme.
	VQ-2 ... të marrin pjesë në diskutime dhe aktivitete që promovojnë inkluzivitet në mjedise të ndryshme.
	VQ-5 ... të angazhohen për drejtësi në ndërveprimet e përditshme dhe në politikën, si dhe për trajtim të drejtë për të gjithë, pa marrë parasysh prejardhjen, aftësitë apo karakteristikat e tjera.
	VQ-6 ... të mbështesin sisteme që sigurojnë qasje të barabartë në mundësi dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut.
	VQ-3 ... të demonstrojnë vetëdije dhe përgjegjësi ndaj çështjeve globale si ndryshimet klimatike, pabarazia dhe varfëria.

PËRGJEGJËSIA DHE QËNDRUESHMËRI A GLOBALE	VQ -4	... të kontribuojnë në nismat dhe realizimin e iniciativave që adresojnë sfidat globale dhe promovojnë mirëqenie globale.
	VQ -7	... të integrojnë parimet e qëndrueshmërisë në marrjen e vendimeve, duke marrë parasysh pasojat e veprimeve të tyre mbi mjedisin dhe shoqërinë.
	VQ -8	... të promovojnë praktika që kontribuojnë në zhvillim të qëndrueshëm dhe menaxhim të përgjegjshëm të burimeve.
TRANSAPRENCA DHE FLEKSIBILITETI	VQ -9	... të demonstrojnë hapje ndaj koncepteve, metodave dhe informacionit të ri dhe të shqyrtojnë problemet nga perspektiva të ndryshme.
	VQ -10	... të demonstrojnë gatishmëri për bashkëpunim me grupe të ndryshme kulturore dhe sociale në kushte të ndryshme.
INICIJATIVAT DHE KËMBËNGULSIA	VQ -11	... të marrin iniciativë në planifikimin e aktiviteteve të të nxënësve dhe të demonstrojnë se mund të organizohen vetë për zbatimin e tyre.
	VQ -12	... të qëndrojnë të vendosur në zgjidhjen e problemeve dhe arritjen e qëllimeve, edhe kur përballen me sfida dhe dështime.
	VQ -13	... të synojnë të tejkalojnë barrierat në mësim dhe të jenë të qëndrueshëm kur përballen me situata komplekse.

Implementimi i Kornizës së gjimnazit

Korniza kombëtare e kompetencave kryesore për nxënësit në arsimin e mesëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut përfaqëson një themel për zhvillimin e brezave të ardhshëm të përgatitur për t'u përballur me sfidat komplekse të shoqërisë moderne. Ky dokument i udhëzon nxënësit drejt aritjes jo vetëm të njohurive themelore akademike, por edhe të aftësive, vlerave dhe qëndrimeve që i formojnë ata si qytetarë të pavarur, përgjegjës shoqëror dhe aktivë globalisht. Këto kompetenca i përgatitin ata të jenë pjesëmarrës aktivë në botën globale, me fokus në inovacion, qëndrueshmëri dhe drejtësi.

Për të siguruar integrimin dhe zotërimin e plotë të këtyre kompetencave kryesore, ato duhet të inkorporohen në të gjitha aspektet e jetës shkollore – jo vetëm në programet mësimore, por edhe në aktivitetet jashtëmësimore, programet për zhvillim personal dhe social, si dhe në të gjithë jetën dhe etosin e shkollës. Programet mësimore janë hartuar në mënyrë që të nxisin ndërdisiplinartetin, zotërimin e aftësive praktike dhe aplikimin e njohurive, përmes aktiviteteve si puna me projekte, zgjidhja e problemeve, bashkëpunimi në grup dhe mendimi kritik. Aktivitetet jashtëmësimore (klubet, aksionet vullnetare, sportet etj.) krijojnë mundësi për zhvillimin e aftësive sociale dhe emocionale, ndërsa përmes veprimtarisë shoqërisht të dobishme nxiset adoptimi i vlerave si bashkëpunimi, empatia dhe lidërshipi.

Etosi i përgjithshëm i shkollës duhet të ndërtohet mbi bazën e këtyre kompetencave, duke promovuar një kulturë të përfshirjes, drejtësisë, përgjegjësisë dhe sjelljes etike. Në këtë atmosferë, nxënësit trajtohen si pjesëmarrës aktivë në marrjen e vendimeve përmes strukturave demokratike, si komunitetet klasore dhe këshillat e nxënësve, të cilat i inkurajojnë ata të marrin përgjegjësi për jetën në shkollë dhe në komunitet. Shkollat duhet të punojnë për të krijuar mjedise ku respektohen dallimet, ku nxënësit inkurajohen të mësojnë nga gabimet e tyre dhe të zhvillojnë qëndrueshmëri dhe vendosmëri në arritjen e qëllimeve të tyre.

Me një qasje të tillë holistike, shkollat sigurojnë që kompetencat të jenë të zbatueshme praktikisht në çdo aspekt të jetës së nxënësve. Në këtë mënyrë, arsimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut realizon misionin e tij – të krijojë breza të përgatitur për të ardhmen, të aftë të mendojnë në mënyrë kritike, të veprojnë me përgjegjësi dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive për përparimin shoqëror.

PLANI MËSIMOR

Plani mësimor për arsimin e mesëm gjimnaz të përgjithshëm ofron zhvillim të gjithanshëm të nxënësve përmes mëimit të lëndëve të detyrueshme, lëndëve zgjedhore dhe aktiviteteve të organizuara jashtë mëimit. Plani mësimor mundëson zotërimin e njohurive dhe aftësive, si dhe zhvillimin e qëndrimeve dhe vlerave nga fusha të ndryshme, duke përfshirë gjuhët, shkencat natyrore dhe shoqërore, artet, sportin dhe teknologjinë. Kjo strukturë e planit mësimor siguron zhvillim të plotë personal, social dhe akademik duke inkurajuar nxënësit të njohin një gamë të gjerë disiplinash dhe të zhvillojnë interesa dhe kompetenca që do t'i përgatitin për arsimin e mëtejshëm dhe jetën e përditshme.

Lëndët e detyrueshme përbëjnë bazën e arsimit të mesëm dhe sigurojnë një përfshirje të gjerë të njohurive nga fusha të ndryshme të arsimit. Përmes mëimit të këtyre lëndëve, nxënësit fitojnë njohuri themelore dhe kompetenca në fushën e shkencave natyrore, shkencave shoqërore, disiplinave humaniste dhe arteve, që përbën bazën për zhvillimin personal, arsimin e mëtejshëm akademik dhe pjesëmarrjen aktive në shoqërinë moderne.

Gjatë të katër viteve të arsimit të mesëm, lëndët e detyrueshme përfshijnë: gjuhën dhe letërsinë maqedonase, ose gjuhën dhe letërsinë shqipe, turke ose serbe, matematikën, gjuhën angleze, një gjuhë të dytë të huaj dhe sportin. Këto lëndë sigurojnë vazhdimësi në zhvillimin e kompetencave gjuhësore, matematikore, komunikative dhe psiko-fizike të nxënësve.

Lënda e Historisë është e detyrueshme për tre vite, duke i mundësuar nxënësve të fitojnë njohuri të strukturuar mbi proceset historike dhe zhvillimin e shoqërisë. Lëndët: gjeografia, biologji, kimi, fizikë dhe Informatikë janë të detyrueshme gjatë dy viteve të para, me qëllim ndërtimin e njohurive bazë në shkencat natyrore dhe shkrim – leximin digjital.

Arti figurativ dhe Arti muzikor janë lëndë të detyrueshme gjatë dy viteve të para, duke nxitur zhvillimin estetik, kreativitetin dhe alfabetizimin kulturor të nxënësve. Lënda e Sociologjisë mësohet si lëndë e detyrueshme në vitin e dytë, ndërsa lënda e Filozofisë realizohet si e detyrueshme në vitin e katërt.

Për më tepër, nxënësit që nuk ndjekin mësimin në gjuhën maqedonase, detyrimisht mësojnë Gjuhën dhe letërsinë maqedonase gjatë të katër viteve, duke siguruar kështu integrim gjuhësor dhe zhvillim të kompetencave komunikative të nevojshme për arsimin e mëtejshëm dhe pjesëmarrjen aktive në jetën shoqërore.

Lëndët zgjedhore realizohen në vitin e tretë dhe të katërt të arsimit të mesëm në gjimnaz, duke mundësuar thellimin e njohurive dhe individualizimin e rrugës arsimore të nxënësve. Në planin mësimor janë parashikuar dy lloje lëndësh zgjedhore: lëndë zgjedhore që mësohen për dy vite dhe lëndë zgjedhore që mësohen për një vit.

Lëndët zgjedhore që mësohen për dy vite janë të organizuara në tri grupe (blloqe) zgjedhore, ku secili nxënës zgjedh nga një lëndë nga secili grup. Në këtë mënyrë, çdo nxënës zgjedh gjithsej tre lëndë zgjedhore dyvjeçare, të cilat i ndjek në mënyrë të vazhdueshme në vitin e tretë dhe të katërt. Ky sistem përzgjedhjeje mundëson kombinim të balancuar të fushave të ndryshme të dijes dhe organizim të pandërprerë të procesit mësimor. Në grupin e lëndëve zgjedhore dyvjeçare përfshihen: Biologjia, Gjeografia, Kimia, Fizika, Psikologjia, Logjika dhe Etika, ku lëndët nga fusha e filozofisë përfaqësohen përmes lëndës Logjika dhe Etika si një lëndë zgjedhore e veçantë.

Lëndët zgjedhore dyvjeçare mundësojnë studim më të thelluar të përmbajtjeve mësimore dhe zhvillim të aftësive më të larta njohëse dhe kërkimore. Një pjesë e këtyre lëndëve mbështeten në njohuritë e fituara gjatë dy viteve të para, por në vitin e tretë dhe të katërt realizohen në një nivel më të avancuar dhe më analitik, duke i përgatitur nxënësit për arsimim të mëtejshëm akademik dhe orientim profesional.

Lëndët zgjedhore njëvjeçare janë të organizuara në dy grupe zgjedhore në vitin e tretë dhe dy grupe zgjedhore në vitin e katërt. Në çdo vit shkollor, secili nxënës zgjedh dy lëndë zgjedhore njëvjeçare, nga një lëndë nga secili grup zgjedhor. Në klasën e tretë si lëndë zgjedhore njëvjeçare realizohen: Programimi, Sociologjia, Ekonomia dhe Gjuha Latine dhe Kultura Klasike, ndërsa në vitin e katërt realizohen: Matematika e Avancuar, E Drejta, Biznesi dhe Sipërmarrja dhe Historia.

Një pjesë e lëndëve zgjedhore njëvjeçare (si Sociologjia, Historia, Programimi dhe Matematika e Avancuar) mundësojnë studim më të thelluar të temave nga lëndë dhe/ose disiplina që në vitet e mëparshme kanë qenë të përfshira si lëndë të detyrueshme. Në këtë grup lëndësh ofrohen edhe lëndë të tilla (si Ekonomia dhe E Drejta) që janë të konceptuara si hyrëse, por edhe të tilla që, përveçse prezantohen si të reja, ofrojnë edhe qasje ndërdisiplinore. Për shembull, lënda Gjuha Latine dhe Kultura Klasike integron njohuritë gjuhësore me trashëgiminë kulturore dhe historinë antike.

Me futjen e lëndëve zgjedhore mundësohet fleksibilitet më i madh dhe individualizim i procesit mësimor, ku çdo nxënës formon profilin e vet arsimor në përputhje me interesat, aftësitë dhe planet e tij të ardhshme arsimore. Për të siguruar një zgjedhje të informuar dhe të përshtatshme, nxënësit marrin mbështetje përmes këshillimit për karrierë dhe ndihmës profesionale nga stafi mësimor dhe ai profesional i shkollës.

Përveç kësaj, shkolla është e detyruar të ofrojë edhe të ashtuquajturat **Lëndë zgjedhore të lira**, të cilat realizohen në formë punëtorish ose aktiviteteve projektore. Lëndët zgjedhore të lira duhet të jenë nga fusha të ndryshme (si: shëndeti mendor dhe mirëqenia, edukimi shëndetësor dhe seksual, inteligjenca artificiale, komunikimi jodhunshëm dhe zgjidhja e konflikteve, retorika, inovacionet dhe kultura financiare, si dhe nga fusha e arteve dhe kulturës – arti muzikor dhe arti pamor), me qëllim që të sigurojnë njohuri praktike dhe aftësi jetësore që plotësojnë përmbajtjet e përgjithshme arsimore të gjimnazit dhe t'u mundësojnë nxënësve të fitojnë kompetenca që do t'i ndihmojnë të përballen me sfidat bashkëkohore dhe të përgatiten për pjesëmarrje aktive në shoqëri.

Çdo nxënës zgjedh dy lëndë në çdo vit shkollor (nga një në secilin gjysmëvjetor), që do të thotë se deri në përfundimin e arsimit gjimnazor ai ndjek gjithsej tetë lëndë zgjedhore të lira. Se cilat lëndë dhe në cilin vit do t'i zgjedhë, varet nga vetë nxënësi.

Sipas planit mësimor, nxënësit marrin pjesë në **punën e dobishme shoqërore** (36 orë në vit), me qëllim që të zhvillojnë ndërgjegjësim për komunitetin dhe përgjegjësinë ndaj shoqërisë. Përmes këtyre aktiviteteve, nxënësit zhvillojnë empati dhe mësojnë se si të kontribuojnë në komunitet.

Përveç kësaj, shkollat janë të obliguara të organizojnë **klube dhe lloje të tjera të aktiviteteve jashtëmësimore**, si: (1) kori shkollor ose orkestri/bendi shkollor, (2) teatri shkollor, (3) klubet sportive dhe (4) klubet e arteve pamore. Shkolla i inkurajon nxënësit të marrin pjesë në këto aktivitete me qëllim që të nxitet kreativiteti, puna në ekip dhe zhvillimi personal.

Përmbledhje e përfitimeve kryesore të planit mësimor për arsimin në gjimnaz:

- **Zhvillim i gjithanshëm:** Fitimi i njohurive, aftësive dhe qëndrimeve përmes lëndëve të detyrueshme dhe zgjedhore, si dhe përmes aktiviteteve jashtëmësimore.
- **Individualizimi i mësimi:** Mundësi për nxënësit që të formojnë profilin e tyre arsimor përmes zgjedhjes së lëndëve sipas interesave personale.
- **Aftësi praktike për jetën:** Zhvillimi i përgjegjësisë personale, i të menduarit kritik dhe i ndërgjegjësimit për çështjet shoqërore përmes lëndëve zgjedhore të lira.
- **Punë shoqërore e dobishme:** Nxitja e ndërgjegjësimit për komunitetin dhe e përgjegjësisë ndaj shoqërisë përmes aktiviteteve të detyrueshme.
- **Kreativitet dhe punë në ekip:** Nxitja e zhvillimit personal përmes pjesëmarrjes në klube të artit, sportit, teatrit dhe muzikës.

Plani mësimor për arsimin në gjimnaz

	Lëndët mësimore	Viti I		Viti II		Viti III		Viti IV	
		jav.	vit.	jav.	vit.	jav	vit.	jav.	vit.
Lëndët e detyrueshme									
1.	Gjuhë maqedonase dhe letërsi/ Gjuhë shqipe dhe letërsi/ Gjuhë turke dhe letërsi/ Gjuhë serbe dhe letërsi	4	144	4	144	4	144	4	132
	Gjuhë maqedonase dhe letërsi për nxënësit e bashkësive të tjera	2	72	2	72	2	72	2	66
2.	Matematikë	3	108	3	108	3	108	3	99
3.	Gjuhë angleze	3	108	3	108	3	108	3	99
4.	Gjuhë e dytë e huaj	2	72	2	72	2	72	2	66
5.	Informatikë	2	72	2	72				
6.	Histori	2	72	2	72	2	72		
7.	Gjeografi	2	72	2	72				
8.	Biologji	2	72	2	72				
9.	Kimi	2	72	2	72				
10.	Fizikë	2	72	2	72				
11.	Filozofi							3	99
12.	Sociologji			2	72				
13.	Art figurativ	2	72	1	36				
14.	Art muzikor	1	36	2	72				
15.	Sport	2	72	2	72	3	108	3	99
Lëndë zgjedhore ²									

² Zgjedhja e lëndëve zgjedhore bëhet sipas blloqeve, ku nxënësi zgjedh nga një lëndë nga secili bllok, me qëllim që të sigurohet organizimi dhe realizimi i pandërprerë i procesit mësimor.

Lëndë zgjedhore që mësohen për 2 vite ³									
1.	Biologji					2	72	2	66
1.	Gjeografi					2	72	2	66
2.	Kimi					2	72	2	66
2.	Etikë logjike					2	72	2	66
3.	Fizikë					2	72	2	66
3.	Psikologji					2	72	2	66
Lëndë zgjedhore që mësohen për 1 vit ⁴									
1.	Programim					3	108		
1	Sociologji					3	108		
2.	Ekonomi					3	108		
2.	Gjuhë latine dhe kulturë klasike					3	108		
1.	Matematikë e avancuar							3	99
1.	E drejta							3	99
2.	Biznes dhe sipërmarrësi							3	99
2.	Histori							3	99
	Orët e përgjithshme (lëndë të detyrueshme dhe zgjedhore)	29 (31)		31 (33)		29 (31)		30 (32)	
	Numri i përgjithshëm i lëndëve								
Aktivitete të tjera									
	Lëndë e lirë zgjedhore ⁵	2	72	2	72	2	72	2	66
	Punë e dobishme shoqërore ⁶		36		36		36		36
	Ora e kujdestarisë/ Organizimi i nxënësve	1	36	1	36	1	36	1	33
	Aktivitet jashtëmësimore ⁷	2	72	2	72	2	72	2	66

³ Çdo nxënës zgjedh tre lëndë zgjedhore që mësohen për dy vite, duke zgjedhur nga një lëndë nga secili nga tre blloqet e përcaktuara zgjedhore.

⁴ Çdo nxënës, sipas interesave të tij, zgjedh dy lëndë zgjedhore që mësohen për një vit, nga një lëndë nga secili nga dy blloqet zgjedhore në vitin III dhe respektivisht në vitin IV.

⁵ Nxënësi zgjedh dy lëndë zgjedhore të lira gjatë një viti shkollor – nga një lëndë në secilën gjysmëvjetor. Çdo vit shkollor, nxënësi zgjedh lëndë të ndryshme zgjedhore të lira.

⁶ Çdo nxënës është i obliguar të marrë pjesë në aktivitete shoqërore me dobi për komunitetin, me një total prej 36 orësh në vit. Këto aktivitete kanë për qëllim zhvillimin e ndërgjegjësimit për komunitetin, përgjegjësinë ndaj shoqërisë dhe empatinë te nxënësit. Përmes këtij angazhimi, nxënësit mësojnë si të kontribuojnë për të mirën e komunitetit, gjë që është e rëndësishme për zhvillimin e tyre personal dhe përgjegjësinë qytetare.

⁷ Çdo shkollë duhet të organizojë: korin shkollor dhe/ose orkestrin/bendin shkollor, teatrin shkollor, klubet sportive të shkollës dhe klubin e arteve pamore/multimedia.

PROGRAMET MËSIMORE

Programet mësimore për lëndët e detyrueshme, për lëndët zgjedhore dhe për lëndët zgjedhore të lira hartohen në nivel kombëtar nga ekipe profesionale. Për aktivitetet jashtëmësimore dhe punën e dobishme shoqërore, në nivel kombëtar hartohen udhëzime për planifikimin, organizimin dhe realizimin e tyre, ndërsa vetë programet i hartojnë mësimdhënësit në shkolla.

Programet mësimore për arsimin gjimnazor fokusohen në zhvillimin e kompetencave përmes temave të menduara me kujdes, rezultateve e të nxënës, përmbajtjeve, standardeve të vlerësimit dhe aktiviteteve.

Temat/Fushat

Çdo lëndë mësimore mësohet përmes temave ose fushave. Temat dhe fushat emërtohen ndryshe për të pasqyruar rolin e tyre brenda programit mësimor. Lëndët që bazohen në koncepte dhe fakte (p.sh. shkencat natyrore) përdorin temën si njësi bazë, ndërsa lëndët që zhvillojnë aftësi integruese dhe të vazhdueshme (p.sh. gjuha amtare) përdorin fushën si kornizë bazë.

Temat përcaktohen për lëndët që kërkojnë studim të fokusuar dhe të përsëritur të koncepteve specifike, të cilat mund të trajtohen dhe vlerësohen brenda një periudhe më të shkurtër kohe. Ato janë aspekte të kufizuara dhe konkrete të lëndës që studiohen si njësi të veçanta, të pavarura ose të lidhura me njëra-tjetrën. Lëndë si shkencat natyrore (Kimia, Biologjia, Fizika) ose shkencat shoqërore dhe humaniste (Gjeografia, Historia) zakonisht fokusohen te temat, sepse njohuritë në këto fusha organizohen në njësi të qarta, të cilat i lejojnë nxënësit të eksplorojnë konceptet në thellësi brenda një periudhe të caktuar kohore.

Fushat janë zona më të gjera me përmbajtje të ndryshme, që kërkojnë studim të vazhdueshëm, të lidhur dhe afatgjatë. Njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet/vlerat që duhet të fitohen brenda një fushe lidhen jo vetëm me njëra-tjetrën, por edhe me përmbajtjet e fushave të tjera, duke mundësuar një të mësuar të integruar dhe afatgjatë. Kjo siguron që njohuritë e fituara të mos mbeten të kufizuara vetëm te një temë, por të aplikohen dhe të zhvillohen vazhdimisht gjatë mësimin të lëndës. Në lëndë si Gjuha maqedonase dhe letërsia / Gjuha shqipe dhe letërsia / Gjuha turke dhe letërsia / Gjuha serbe dhe letërsia, njohuritë dhe aftësitë bazë fitohen përmes përvetësimit të njësive mësimore të veçanta, por të mësuara në mënyrë të vazhdueshme dhe të lidhur me njëra-tjetrën brenda të njëjtës fushë dhe fushave të tjera (p.sh. gramatika është gjithmonë e pranishme, pavarësisht përmbajtjes specifike). Shembull: Një temë nga Kimia do të ishte: “Kinetika e reaksioneve kimike”, një fushë në Gjuha maqedonase/shqipe/turke/serbe dhe letërsia: “Shkrim-leximi mediatik”.

Përmbajtjet dhe nocionet

Përmbajtjet përcaktojnë strukturën e temës/fushës. Ato përbëjnë kornizën e njohurive (informacioneve) që nxënësit duhet t'i fitojnë. Çdo temë/fushë përfshin të paktën dy përmbajtje mësimore.

Brenda përmbajtjeve përmenden nocionet kryesore që janë të rëndësishëm për përvetësimin e përmbajtjes mësimore. Pritet që nxënësit t'i kuptojnë këta nocione në mënyrë që të mund të aplikojnë njohuritë e fituara nga përmbajtja përkatëse në kontekste të ndryshme gjatë procesit të mësimnxënies.

Rezultatet e të nxënit

Për çdo temë/fushë jepen rezultatet e të nxënit, të cilat janë të përcaktuara si arritje globale që burojnë nga studimi i temës/fushës. Ato mund të lidhen me njohuritë dhe aftësitë, të cilat shpjegohen më në detaje përmes standardeve për vlerësim, si dhe me vlerat dhe qëndrimet që pritët të përvetësojnë nxënësit gjatë mësimit të temës/fushës.

Rezultatet e të nxënit që përfshijnë njohuritë dhe aftësitë janë të matshme drejtpërdrejt përmes standardeve për vlerësim, dhe arritja e tyre reflektohet në notë.

Nga ana tjetër, arritja e rezultateve që lidhen me qëndrimet dhe vlerat është një proces afatgjatë dhe gradual, i cili nuk mund të matet drejtpërdrejt, por ndiqet përmes të nxënit të vazhdueshëm dhe aplikimit të aktiviteteve që nxisin dhe mbështesin zhvillimin e tyre.

Standardet për vlerësim

Standardet për vlerësim janë rezultate konkrete të të nxënit që operacionalizojnë njohuritë dhe aftësitë të përcaktuara nga rezultatet e të nxënit. Në fakt, standardet për vlerësim përcaktohen si rezultate të matshme të të nxënit, të cilat implicitisht tregojnë mënyrën se si mund të verifikohet nëse është arritur rezultati i pritur. Ato përcaktohen në të paktën katër nivele të arritjeve njohëse të nxënësve, sipas taksonomisë së Blum-it: njohuri, kuptim, aplikim dhe analizë/vlerësim/krijim.

Standardet për vlerësim ndihmojnë mësimdhënësit në përcaktimin/formësimin e kriterëve për vlerësim, duke kontribuar kështu në rritjen e objektivitetit dhe transparencës në procesin e vlerësimit.

Aktivitetet

Në programin mësimor, për çdo temë/fushë jepen shembuj të aktiviteteve të ndryshme që mundësojnë të nxënit përmes përvojës. Aktivitetet mund të jenë: detyra individuale, diskutime, ushtrime, debate, eksperimente, projekte, hulumtime ose çdo lloj aktiviteti karakteristik për lëndën përkatëse.

Shembujt e aktiviteteve lidhen me standardet për vlerësim dhe kanë për qëllim arritjen e tyre. Njëkohësisht, ato shërbejnë si model për organizimin e mësimdhënies – u japin udhëzime mësimdhënësve se si të krijojnë aktivitete që realizojnë të gjitha standardet e parashikuara për vlerësim.

Mësimdhënësit ruajnë lirinë të krijojnë aktivitete dhe materiale mësimore të ndryshme, të cilat i lejojnë të përshtatin mësimin sipas nevojave të nxënësve, me qëllim që të sigurohet niveli i njohurive dhe aftësive të përcaktuar nga standardet e vlerësimit. Gjithashtu, është e rëndësishme që aktivitetet të jenë në përputhje me qëndrimet dhe vlerat të përcaktuara nga rezultatet e të nxënit.

Përmbledhje e përfitimeve kryesore të programeve mësimore sipas konceptit

- **Fokus në kompetenca:** Zhvillimi i njohurive, aftësive dhe qëndrimeve përmes temave, përmbajtjeve dhe aktiviteteve.
- **Strukturë e qartë:** Tema për koncepte konkrete dhe fusha për të nxënë në mënyrë të integruar dhe afatgjatë.
- **Objektivitet në vlerësim:** Standardet e vlerësimit që mundësojnë transparencë dhe objektivitet në vlerësim.
- **Të nxënë përmes përvojës:** Përfshirja e aktiviteteve si debate, projekte dhe hulumtime për arritjen e rezultateve të pritura të të nxënit.
- **Fleksibilitet për mësimdhënësit:** Liri për të përshtatur aktivitetet mësimore sipas nevojave të nxënësve.

MËSIMDHËNIA DHE MËSIMNXËNIA

Planifikimi i mësimit

Planifikimi i mësimit është parakusht për një përgatitje, organizim dhe realizim të suksesshëm, të drejtë në kohë dhe efektiv të procesit mësimor. Ai bazohet në programin mësimor dhe merr parasysh karakteristikat e nxënësve (moshën, njohuritë paraprake, nevojat, mundësitë dhe aftësitë e tyre) si dhe kushtet dhe mjetet e punës që ka në dispozicion mësimdhënësi, dmth. shkolla.

Gjatë planifikimit, mësimdhënësit konceptojnë aktivitetet që do të përdorin për të siguruar arritjen e rezultateve të pritura të të nxënit, zgjedhin dhe/ose krijojnë mjetet mësimore që do të përdoren dhe përcaktojnë mënyrën e monitorimit dhe verifikimit të arritjeve të nxënësve. Në këtë proces, përdoret planifikim procesor dhe zhvillimor.

Qasja procesore-zhvillimore në planifikim thekson rëndësinë e procesit të të nxënit në përvetësimin e njohurive. Në vend që të stimulojë thjesht transmetimin e njohurive të parapërgatitura dhe të dhëna në formë të gatshme, ajo fokusohet te procesi i përvetësimit të njohurive dhe zhvillimit të aftësisë për të mësuar tek nxënësit.

Në këtë qasje, njohuritë nuk shihen si rezultat i veprimeve të mësimdhënësit, por si pasojë e aktiviteteve që realizojnë nxënësit. Ajo që bëjnë nxënësit gjatë orës ka shumë më shumë rëndësi sesa ajo që bën mësimdhënësi.

Ky qasje nënvizon se arritja e rezultateve të dëshiruara rritet nëse planifikimi fokusohet tek: aktivitetet e nxënësve gjatë procesit të të nxënit (komponenta procesuale) dhe aftësimi i nxënësve për të mësuar përmes zbulimit të njohurive, jo vetëm përmes transmetimit të tyre (komponenta zhvillimore).

Kur planifikimi bazohet në qasjen procesore-zhvillimore, mbahet parasysh se roli i mësimdhënësit nuk është të prezantojë nxënësve përmbajtjet që duhet të mësojnë, por t'i vendosë ata në situata problematike dhe t'i nxisë të reagojnë në mënyrë të përshtatshme ndaj këtyre problemeve.

Kjo mund të arrihet në një mjedis të të nxënit (si fizik ashtu edhe social) që i stimulojnë nxënësit të përfshihen aktivisht në procesin mësimor – nxënësi duhet të fillojë fillimisht të shfaqë interes, në mënyrë që më pas të mund të orientohet drejt asaj që pritet të realizojë.

Qasja e procesit zhvillimor në planifikim siguron që mësimdhënia të jetë e përshtatur me nevojat dhe mundësitë e nxënësve. Mësimdhënësi paraprakisht planifikon realizimin e të gjitha temave/fushave të përfshira në programin mësimor për lëndën e tij dhe më pas planifikon realizimin e secilës temë veç e veç, përkatësisht të komponentëve të ndryshëm të fushave. Ajo që planifikohet në këtë mënyrë nuk konsiderohet si diçka fikse, por përkundrazi si fleksibile – lihet hapësirë që të ndryshohet renditja e studimit të temave dhe të rishpërndahet koha që fillimisht është caktuar për studimin e secilës temë. Fleksibiliteti i referohet edhe temave konkrete, numrit të orëve, zgjedhjes së metodave dhe aktiviteteve mësimore dhe/ose përfaqësimit të mjeteve të ndryshme mësimore që janë parashikuar në planifikimin fillestar. Të gjitha ose një pjesë e tyre mund të ndryshohen nëse më shumë nxënës nga paralelja nuk arrijnë të përparojnë në përvetësimin e temës sipas pritjeve të mësimdhënësit.

Përshtatja në planifikimin proces-zhvillimor bazohet në rezultatet e vetëvlerësimit që e bën çdo mësimdhënësi i lëndës në fund të orës mësimore. Vetëvlerësimi është vlerësim i efikasitetit, efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së të gjitha aktiviteteve gjatë orës që janë ndërmarrë për të arritur rezultatet e parashikuara të të nxënësve. Vetëreflektimi u mundëson mësimdhënësit të vërejnë të gjitha vështirësitë me të cilat janë përballur gjatë realizimit të çdo segmenti të mësimin (të nxënësve, mësimdhënies dhe vlerësimit) dhe këto njohuri t'i marrin parasysh në planifikim për të siguruar tejkalimin e dobësive të mundshme në mësimdhënie. Kjo nënkupton ndryshime në mësimdhënie kur bëhet fjalë për përvetësimin aktual të përmbajtjeve të caktuara mësimore dhe arritjen e rezultateve të pritura të të nxënësve tek nxënësit aktualë, por edhe përfshirjen e përvojave të fituara në planifikimin e realizimit të mësimdhënies për nxënësit e ardhshëm.

Qasje inovative në mësim

Mësimdhënia interaktive nënkupton zbatimin e qasjeve që bazohen në metoda të të nxënësve dhe mësimdhënies që sigurojnë pjesëmarrje aktive të nxënësve përmes ndërveprimit të vazhdueshëm të mësimdhënësit me nxënësit, përmes bashkëpunimit ndërmjet nxënësve, përmes përdorimit të mjeteve digjitale/audi vizuale si ndërmjetës, si dhe përmes angazhimit të drejtpërdrejtë të nxënësve në realizimin e aktiviteteve gjatë orës. Përveç qasjes interaktive, e cila duhet të vazhdojë të zbatohet në mënyrë të qëndrueshme, mësimdhënia bashkëkohore e vë theksin edhe te strategjitë e mësimdhënies si: të nxënësve përmes projekteve, të nxënësve përmes përvojës, aktiviteteve kreative, qasja analitike, diskutimet dhe debatet.

Të nxënësve e bazuar në projekte është një strategji e mësimdhënies që u mundëson nxënësve të fitojnë njohuri më të thelluara dhe të zhvillojnë aftësi praktike përmes realizimit të projekteve aplikative me të cilat adresohen sfida dhe probleme nga jeta e përditshme. Aktivitetet e projekteve i angazhojnë nxënësit në zgjidhjen e problemeve reale ose në kërkimin e përgjigjeve për pyetje më komplekse. Përmes tyre nxënësit fitojnë njohuri të thelluara dhe të qëndrueshme për përmbajtje të caktuara mësimore, zhvillojnë kureshtjen, kreativitetin dhe mendimin kritik, si dhe përmirësojnë aftësitë e tyre komunikuese dhe aftësitë për punë të pavarur dhe për punë në ekip. Për shembull, në lëndët e shkencave natyrore, nxënësit mund të hulumtojnë ndotjen në një lumë lokal përmes matjeve, analizës së të dhënave dhe propozimit të zgjidhjeve, ndërsa në Gjeografi mund të përgatisin një hartë të lokaliteteve turistike me informacione përkatëse për pasuritë kulturore dhe natyrore.

Aktivitetet analitike, si analiza e skenarëve, situatave, teksteve ose problemeve, luajnë një rol të rëndësishëm në mësimdhënie. Këto aktivitete i nxisin nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike, të nxjerrin përfundime dhe të marrin vendime të bazuara në argumente. Për shembull, në Histori, nxënësit mund të marrin detyrë të analizojnë përmbajtjen e letrave të dhëna, artikujve gazetareskë, posterëve dhe fotografive nga koha e Luftës së Dytë Botërore, si mbështetje për shkaqet dhe pasojat e luftës; ndërsa në Ekonomi mund të angazhohen në zgjidhjen e një problemi për menaxhimin e burimeve të kufizuara në një kompani fiktive.

Aktivitetet kreative nxisin imagjinatën dhe origjinalitetin e nxënësve përmes aktiviteteve si realizimi i projekteve artistike, shkrimi i teksteve ose dizajnimi i përmbajtjeve multimediale. Këto aktivitete u mundësojnë nxënësve t'i shprehin idetë e tyre në një mënyrë që i lidh interesat e tyre personale me përmbajtjet mësimore. Për shembull, në Art figurativ, nxënësit mund të realizojnë një mural me tematikë sociale; në Art muzikor mund të krijojnë një kompozim muzikor të frymëzuar nga një ngjarje historike; ndërsa në Informatikë nxënësit mund të dizajnojnë një faqe interneti për një projekt mbi efikasitetin energjetik.

Diskutimi mundëson shkëmbimin e ideve dhe mendimeve ndërmjet nxënësve dhe i nxit ata të mendojnë në mënyrë kritike, të argumentojnë dhe të nxjerrin përfundime. Këto aktivitete promovojnë respektimin e pikëpamjeve të ndryshme dhe zhvillojnë aftësitë për dëgjim aktiv. Për shembull, në lëndët ku mësohet gjuha dhe letërsia mund të zhvillohen diskutime për interpretime të ndryshme të personazheve në një vepër letrare, ndërsa në Filozofi mund të zhvillohet diskutim me temë “Çfarë është drejtësia?” etj.

Debatet janë aktivitete formale ku nxënësit (më së shpeshti të ndarë në grupe “kundërshtarë”) paraqesin argumente pro dhe kundër një çështjeje/pohimi të caktuar. Ato mundësojnë zhvillimin e aftësive të folurit, të mendimit logjik dhe të punës në ekip. Për shembull, në Edukatë qytetare mund të realizohet një debat pro ose kundër dënimit me vdekje, ndërsa në Histori një debat nëse një figurë e caktuar historike ka qenë hero apo figurë negative.

Aktivitetet praktike i integrojnë njohuritë dhe aftësitë që nxënësit i fitojnë në klasë ose jashtë saj. Përmes vizitave në institucione lokale dhe shfaqjeve artistike, përmes zhvillimit të eksperimenteve ose pjesëmarrjes në simulime kompjuterike, nxënësit mësojnë duke fituar përvojë të drejtpërdrejtë. Për shembull, në Biologji, zhvillimi i një eksperimenti për matjen e nivelit të oksigjenit në ujë i ndihmon nxënësit t'i lidhin njohuritë teorike me një situatë reale.

Teknologjia digjitale mundëson përdorimin e mjeteve dhe burimeve interaktive, për shembull për simulime matematikore ose për krijimin e muzikës, gjë që i pasuron metodat e mësimdhënies dhe rrit interesin e nxënësve. Përmes mjeteve digjitale mundësohet përdorimi i njëkohshëm i mediave të ndryshme, si teksti, audio dhe video, duke i bërë përmbajtjet mësimore më të qasshme dhe më kreative.

Gjithnjë e më shumë po gjen zbatim edhe inteligjenca artificiale (IA), e cila hap mundësi të reja për të nxënësit e personalizuar dhe adaptiv. IA mund të përdoret për krijimin e detyrave interaktive që përshtaten sipas ritmit dhe stilit të të nxënësit të çdo nxënësi, si dhe për analizë të automatizuar të arritjeve dhe dhënie të informatare orientuese. Për shembull, platformat e IA mund të identifikojnë fushat ku nxënësi ka vështirësi dhe të ofrojnë materiale ose aktivitete shpesh. Në mësimdhënie, mësimdhënësit mund të përdorin mjete të IA për gjenerimin e kuizeve, simulimeve, analizave të teksteve ose vizualizimeve të të dhënave, duke e pasuruar procesin mësimor dhe duke nxitur angazhim më të madh te nxënësit.

Përveç kësaj, është e rëndësishme që nxënësit të trajnohen për përdorimin e vetëdijshëm dhe kritik të inteligjencës artificiale. Përmes përfshirjes së IA në aktivitete dhe projektet e rregullta, ata do të zhvillojnë shkrim-lexim digjital, mendim analitik dhe aftësi për të vlerësuar përmbajtjet e gjeneruara nga IA. Ndërkohë, mësimdhënësit duhet të marrin trajnim dhe mbështetje të përshtatshme për zbatimin e mjeteve edukative të IA dhe për kuptimin e aspekteve etike, me qëllim që ta përdorin

teknologjinë në mënyrë produktive dhe të përgjegjshme. IA nuk duhet ta zëvendësojë rolin e mësimit, por të jetë një mjet që e zgjeron potencialin e tij.

Përmbledhje e përfitimeve kryesore nga mësimit dhe të nxënësve të parashikuara me konceptin

- **Planifikim cilësor i mësimit:** Qasje e menduar mirë që i merr parasysh nevojat e nxënësve dhe përshtatet në mënyrë fleksibile me situata të ndryshme.
- **Strategji inovative të mësimit:** Realizimi i mësimit interaktiv dhe i të nxënësve aktiv përmes projekteve, aktiviteteve analitike, diskutimeve dhe debateve.
- **Zhvillimi i mendimit kritik dhe aftësive praktike** përmes punës në detyra analitike dhe pjesëmarrjes në diskutime, debate dhe aktivitete kreative.
- **Të nxënësve përmes përvijës:** Nxënësve fitojnë njohuri dhe aftësi përmes pjesëmarrjes në aktivitete praktike dhe situata reale.
- **Integrimi i teknologjive digjitale:** Zbatimi i mjeteve bashkëkohore për një të nxënësve më të pasur dhe më kreative.

MJETET MËSIMORE

Mjetet mësimore përbëjnë bazën për sigurimin e një arsimit cilësor që është bashkëkohor, interaktiv dhe i orientuar drejt mendimit kritik dhe zbatimit të njohurive në situata reale. Në arsimin gjimnazor, mësimit dhe nxënësve kanë qasje në materiale të ndryshme mësimore, burime digjitale dhe mjete ndihmëse që mundësojnë fleksibilitet dhe inovacion në procesin mësimor. Përmes tyre, mësimit mund ta përshtatë procesin e mësimit sipas nevojave individuale, interesave dhe stileve të të nxënësve, gjë që është veçanërisht e rëndësishme për këtë fazë arsimore.

Qëllimi i këtyre mjeteve është t'u mundësojë nxënësve jo vetëm të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e parashikuara nga programi mësimor, por edhe të zhvillojnë aftësi për hulumtim të pavarur, zgjidhje të problemeve dhe zbatim të asaj që kanë mësuar në kontekste të ndryshme. Njëkohësisht, ato nxisin zhvillimin socio-emocional të nxënësve përmes aktiviteteve kreative, bashkëpunuese dhe eksperimentale.

Tekstet shkollore

Të gjitha lëndët e detyrueshme, si dhe lëndët zgjedhore të dedikuara për mësim të thelluar ose fillestar, do të mbulohen me tekste mësimore përkatëse që janë në përputhje me programet mësimore dhe standardet e të nxënësve. Për këto lëndë do të sigurohen tekste mësimore të botuara ose digjitale, të cilat mundësojnë një qasje bashkëkohore dhe të qasshme ndaj njohurive.

Nga ana tjetër, për lëndët zgjedhore të lira nuk janë parashikuar tekste të standardizuara; realizimi i tyre do të mbështetet përmes krijimit dhe përdorimit të materialeve të ndryshme mësimore dhe didaktike – si udhëzues, manuale për mësimit, prezantime dhe përmbajtje digjitale. Ky fleksibilitet u mundëson mësimit të përshtatet sipas interesave të nxënësve dhe kontekstit specifik të mësimit.

Tekstet digjitale integrojnë tekst, audio, video dhe animacione, duke e bërë të nxënësve më tërheqës dhe më dinamik. Këto tekste janë interaktive – përfshijnë detyra që sigurojnë informim të menjëhershëm, udhëzime për aktivitete shpesh dhe mundësi për përshtatje të përmbajtjeve sipas përparimit individual të nxënësve. Ato jo vetëm që mbështesin nxënësve me nevojat të ndryshme, por gjithashtu bëjnë të

nxënit të qasshëm si në klasë, ashtu edhe në kushte të mësimit në distancë.

Tekstet mësimore kanë për qëllim të shërbejnë si mbështetje për nxënësit gjatë procesit të të nxënit, dhe jo si mjet për mësimdhënësit për realizimin e orës së mësimit.

Pajisjet

Për një realizim më të suksesshëm të mësimdhënies, shkollat janë të pajisura me mjete që mbështesin aktivitete të ndryshme mësimore. Në gjimnaze, kjo përfshin pajisje laboratorike për shkencat natyrore, pajisje multimediale për prezantime audiovizuale dhe materiale manipulativë për të nxënit interaktiv.

Përveç kësaj, gjimnazet kanë infrastrukturë digjitale – kompjuterë, projektorë dhe internet – që mundëson përdorimin e softuerëve edukativë dhe mjeteve digjitale. Për shembull, nxënësit mund të përdorin simulime për eksperimente në fizikë, mjete për vizualizimin e koncepteve matematike, si dhe platforma për punë në grup dhe projekte.

Materialet mësimore

Materialet mësimore shërbejnë si mbështetje për realizimin e mësimdhënies gjatë orës. Mësimdhënësit në arsimin gjimnazial kanë liri të përdorin materiale të gatshme mësimore ose të krijojnë të tyre, sipas nevojave specifike të nxënësve. Materialet që zhvillohen individualisht pritet të ndahen përmes grupeve profesionale dhe/ose platformave digjitale, në mënyrë që të jenë të qasshme edhe për mësimdhënësit të tjerë. Kjo u mundëson mësimdhënësit të përmirësojnë metodat e tyre të punës dhe t'i përshtatin ato sipas situatës konkrete në klasë.

Doracakë për mësimdhënësit

Doracakët për mësimdhënësit janë një burim shtesë që përmbajnë udhëzime, ide dhe/ose shembuj aktivitete për realizimin e mësimdhënies në lëndët e detyrueshme dhe zgjedhore, si dhe për zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore. Doracakët hartohen nga ekipe profesionale ose mësimdhënësit, dhe miratohen nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit.

Përmbledhje e përfitimeve kryesore nga përdorimi i mjeteve mësimore të planifikuara

- **Mësim bashkëkohor dhe interaktiv:** Nxitja e mendimit kritik dhe zbatimi i njohurive në situata reale.
- **Fleksibilitet dhe inovacion:** Përshtatja e procesit mësimor sipas nevojave dhe interesave individuale të nxënësve.
- **Mbështetje për të nxënit në distancë:** Përdorimi i teksteve dhe materialeve digjitale interaktive të qasshme përmes internetit.
- **Lehtësimi i praktikave inovative mësimore:** Përdorimi i pajisjeve laboratorike, pajisjeve multimediale dhe mjeteve digjitale.

VLERËSIMI

Vlerësimi si pjesë integrale e mësimdhënies në gjimnaz

Vlerësimi përbën një komponentë thelbësore të procesit mësimor në gjimnaze, i cili mbështet të nxënit e nxënësve dhe kontribuon në arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit. Ky proces nuk kufizohet vetëm në matjen e njohurive, por ka rolin e një katalizatori që udhëheq mësimdhënien, motivon nxënësit dhe krijon një mjedis që nxit suksesin. Ajo çfarë dhe si mësojnë nxënësit varet në masë të madhe nga ajo çfarë dhe si vlerësojnë mësimdhënësit, dhe një vlerësim cilësor mundëson drejtimin e mësimdhënies drejt nevojave dhe sfidave reale të nxënësve.

Vlerësimi në gjimnaze nuk është një aktivitet i izoluar. Ai është pjesë e të gjitha niveleve të planifikimit – nga strategjitë vjetore të shkollës deri te planet ditore të mësimdhënësve. Institucionet vendosin kuadro që përcaktojnë metodat, parimet dhe kriteret për vlerësim, me qëllim sigurimin e drejtësisë, transparencës dhe qëndrueshmërisë së të gjithë procesit. Politikat e tilla përfshijnë mënyra për mbështetjen e nxënësve që hasin vështirësi, si dhe strategji për përmirësim bazuar në rezultatet e vlerësimeve, përfshirë edhe ato nga testimet ndërkombëtare.

Aspekti kryesor që e bën vlerësimin thelbësor për mësimdhënien është funksioni i tij i dyfishtë: formativ dhe sumativ. Vlerësimi formativ përdoret për të monitoruar procesin e të nxënit dhe për të dhënë reagimin (feedback) në kohë reale, që ndihmon në identifikimin e sfidave dhe udhëheq nxënësit drejt përmirësimit. Nga ana tjetër, vlerësimi sumativ ofron një vlerësim të rezultateve të arritura, duke konfirmuar nëse nxënësi ka zotëruar objektivat e mësimin.

Përveç kësaj, vlerësimi, duke përfshirë standardet e tij, aktivitetet dhe detyrat përmes të cilave nxënësit vlerësohen, është i harmonizuar me kërkesat dhe qasjet kryesore të testeve ndërkombëtare, si PISA. Ky harmonizim mundëson zhvillimin dhe verifikimin e kompetencave të rëndësishme për jetën reale, si mendimi kritik, zgjidhja e problemeve, leximi me kuptim dhe zbatimi funksional i njohurive. Kështu, pritet që nxënësit jo vetëm të jenë më të mirë të përgatitur për pjesëmarrje në këto teste, por edhe të zhvillojnë aftësi të përdorshme në jetën e përditshme dhe në edukimin e mëtejshëm.

Vlerësimi formativ si nxitës për të mësuarit

Vlerësimi formativ përbën një proces të vazhdueshëm që realizohet gjatë mësimdhënies me qëllim të mbështetjes së të nxënësve dhe përmirësimit të përparimit të tyre. Përmes aktiviteteve interaktive, si diskutime, kuize dhe detyra, mësimdhënësit mbledhin informacione mbi mënyrën se si nxënësit kuptojnë materialin dhe ku hasin vështirësi. Feedback-u jepet në mënyrë konstruktive, shpesh me udhëzime për përmirësim, për të nxitur nxënësit të reflektojnë mbi përparimin e tyre dhe të përmirësojnë strategjitë e të nxënësve.

Integrimi i mjeteve digjitale në vlerësim e avancion këtë praktikë duke mundësuar monitorim të shpejtë dhe efikas të arritjeve. Platforma të ndryshme për kuize online, aplikacionet për analizë të të dhënave dhe mjetet për lojërim krijojnë një mjedis angazhues që e bën të nxënësve dinamik dhe motivues. Mësimdhënësit i përdorin këto teknologji për të identifikuar nevojat individuale të nxënësve dhe për të përshtatur metodat e tyre mësimore. Në këtë proces, nxënësit inkurajohen të marrin pjesë aktive përmes vetëreflektimit dhe vetëvlerësimit, duke forcuar autonominë dhe ndjesinë e përgjegjësisë.

Vlerësimi formativ kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në avancimin e rezultateve të nxënësve, pasi siguron një proces dinamik për monitorim dhe përmirësim të të nxënësve gjatë mësimit. Përmes ndjekjes së rregullt të nivelit të kuptimit, mësimdhënësit mund të identifikojnë shpejt sfidat me të cilat përballen nxënësit dhe të ndërhyjnë në kohë. Kjo mundëson mbështetje të personalizuar, e cila ndihmon nxënësit të kapërcejnë dobësitë e tyre dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Ky qasje përmirëson jo vetëm rezultatet akademike aktuale, por edhe krijon baza të forta për të nxënësit në mënyrë të qëndrueshme.

Vlerësimi formativ mbështet motivimin e nxënësve përmes feedback-ut të qartë dhe konstruktiv. Ky feedback u ndihmon nxënësit të kuptojnë gabimet e tyre si mundësi për të mësuar, duke rritur angazhimin dhe vetëbesimin e tyre. Për më tepër, procesi i vetëvlerësimit dhe reflektimit, pjesë integrale e vlerësimit formativ, i përgatit nxënësit për të nxënë në mënyrë autonome dhe zhvillon aftësinë e tyre për të marrë përgjegjësi mbi të nxënësit.

Kjo qasje është veçanërisht efektiv për nxënësit që kanë nevojë për mbështetje shtesë, pasi ndihmon në zvogëlimin e hendekut në arritje. Duke u fokusuar në kuptim dhe aplikim, dhe jo vetëm në memorizim, vlerësimi formativ mundëson zhvillimin e njohurive më të thella dhe aftësive që janë të domosdoshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe për arritjen e rezultateve të larta në testimet finale.

Duke siguruar përmirësim të rezultateve individuale të nxënësve dhe mbështetje për aftësitë e tyre kritike, vlerësimi formativ përbën bazën për një mësimdhënie efektive dhe bashkëkohore, e cila i përgatit nxënësit për sukses në arsimin aktual dhe të ardhshëm.

Vlerësimi formativ ka ndikim të konsiderueshëm jo vetëm në përparimin e nxënësve, por edhe në cilësinë e mësimdhënies në tërësi. Përmes mbledhjes së informacionit mbi mënyrën se si nxënësit kuptojnë materialin dhe sfidat që hasin, mësimdhënësit marrin një pasqyrë mbi efektivitetin e metodave që përdorin në klasë. Këto njohuri u mundësojnë atyre të përshtatin qasjet e tyre, të përdorin teknika më të ndryshme mësimore dhe të krijojnë aktivitete që përputhen më mirë me nevojat e nxënësve. Si rezultat, mësimi bëhet më interaktiv dhe krejtësisht i orientuar drejt të nxënësve cilësor.

Vlerësimi formativ gjithashtu nxit reflektim tek mësimdhënësit, një element kyç për zhvillimin

profesional. Ata kanë mundësinë të identifikojnë pikat e tyre të forta dhe fushat për përmirësim, duke çuar në përmirësim të vazhdueshëm të procesit mësimor. Rezultati është një proces arsimor më efektiv dhe me cilësi më të lartë, që i përgjigjet nevojave të të gjithë nxënësve.

Vlerësimi sumativ për matjen e rezultateve

Vlerësimi sumativ është një vlerësim përfundimtar i arritjeve të nxënësve, zakonisht në fund të studimit të një teme ose në përfundim të periudhave mësimore (tremujor, gjysmëvjetor ose fundi i vitit shkollor). Rezultati i vlerësimit sumativ është një notë numerike që duhet të pasqyrojë shkallën e zotërimit të rezultateve të pritshme të të nxënësve, dmth. arritjen e standardeve të vlerësimit. Zbatimi i tij bazohet në procedura sistematike dhe të standardizuara që sigurojnë një vlerësim të saktë dhe të besueshëm të njohurive dhe aftësive të nxënësve.

Procesi fillon me dizajnimin e mjeteve të vlerësimit, si teste përfundimtare, projekte, ese, prezantime ose detyra praktike, të cilat lidhen me standardet e vlerësimit të përshkruara në programin mësimor. Është thelbësore që këto mjete të jenë të vlefshme (valide), dmth. të matin pikërisht atë që është qëllimi i të nxënësve, dhe të jenë relevante, duke siguruar që vlerësimi të ketë kuptim për nxënësit. Mësimdhënësit përcaktojnë paraprakisht kriteret dhe shkallët për vlerësim, gjë që e bën procesin transparent për nxënësit dhe prindërit. Objektiviteti sigurohet përmes udhëzimeve dhe procedurave të qarta, duke minimizuar rrezikun e interpretimeve subjektive.

Çfarë e bën vlerësimin sumativ cilësor është aftësia e tij për të siguruar rezultate të drejta dhe të sakta, të cilat pasqyrojnë me saktësi arritjet e nxënësve. Kjo arrihet përmes përdorimit të metodave të ndryshme që lejojnë vlerësimin e aspekteve të ndryshme të të nxënësve, përfshirë aftësitë kognitive dhe praktike.

Vlerësimi sumativ ka gjithashtu një rol të rëndësishëm në analizimin e efektivitetit të strategjive mësimore dhe identifikimin e fushave për përmirësim të mësimin. Rezultatet përdoren si bazë për planifikimin e ndërhyrjeve të ardhshme dhe për sigurimin që procesi mësimor plotëson pritshmëritë dhe nevojat e nxënësve. Përmes transparencës, objektivitetit, vlefshmërisë dhe përdorimit konstruktiv të rezultateve, vlerësimi sumativ bëhet një element kyç për sigurimin e arsimit cilësor.

Në arsimin gjimnazor, vlerësimi sumativ është i harmonizuar me rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe kërkesat e programeve të provimeve për maturën shtetërore. Notat e fituara gjatë vlerësimit të rregullt mbështesin zhvillimin e vazhdueshëm të nxënësve dhe sigurojnë pajtueshmëri me provimet përfundimtare. Ky qasje siguron një përgatitje më të mirë për maturën, si dhe koherencë midis procesit mësimor, standardeve dhe vlerësimit përfundimtar. Në këtë mënyrë krijohet një sistem i parashikueshëm, i drejtë dhe funksional për të gjithë nxënësit.

Përmbledhje/rezume e përfitimeve kryesore nga zbatimi i vlerësimit sipas konceptit

- **Mbështetje për të nxënit:** Vlerësimi formativ ndihmon nxënësit të identifikojnë dobësitë dhe të përmirësojnë strategjitë e tyre të të nxënit.
- **Motivimi i nxënësve:** Vlerësimi cilësor i motivon nxënësit përmes feedback-ut konstruktiv dhe njohjes së arritjeve të tyre.
- **Drejtësi dhe objektivitet:** Kriteret dhe standardet e qarta sigurojnë një proces vlerësimi transparent dhe të drejtë.
- **Vlerësimi i arritjeve:** Vlerësimi sumativ ofron një pasqyrë të qartë të nivelit të arritjeve të nxënësve dhe përbushjes së standardeve të të nxënit.
- **Planifikimi i ndërhyrjeve:** Rezultatet e vlerësimit sumativ ndihmojnë në identifikimin e fushave për përmirësim tek nxënësit dhe në procesin mësimor.

NDJEKJA E CILËSISË SË MËSIMIT

Cilësia në arsim përbën bazën për zhvillimin individual dhe shoqëror, si dhe është kusht themelor për ndërtimin e sistemeve moderne arsimore që i përgjigjen nevojave të shekullit 21. Ajo përfshin sigurimin e mësimdhënies efektive dhe interaktive, arritjet e nxënësve dhe krijimin e një mjedisi që mbështet të nxënit. Është thelbësore që cilësia jo vetëm të sigurohet, por edhe të monitorohet dhe vlerësohet vazhdimisht për të arritur progres të qëndrueshëm.

Një nga mënyrat për të ndjekur cilësinë e arsimit është përdorimi i Programit Ndërkombëtar të Vlerësimit të Nxënësve – PISA, i cili organizohet nga OECD. PISA është një instrument i rëndësishëm për monitorimin e cilësisë së arsimit. Pjesëmarrja e nxënësve në testimet PISA nuk është e rëndësishme vetëm për krahasimin e arritjeve me nxënësit e vendeve të tjera, por edhe për të dhënë një pasqyrë se si sistemi arsimor arrin qëllimin e tij për t'i përgatitur të rinjtë për botën reale.

Përmes matjes së njohurive dhe aftësive të nxënësve në fusha si leximi me kuptim, aftësia matematikore dhe njohuritë shkencore, testimi PISA tregon nëse programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies i përgjigjen nevojave të kohës bashkëkohore. Vlerësimi nxjerr në pah edhe rëndësinë e kompetencave si të menduarit kritik, zbatueshmëria e njohurive dhe aftësia për zgjidhjen e problemeve komplekse. Për më tepër, PISA përfshin edhe arsimimin digjital si një komponent kyç, duke theksuar nevojën për zhvillimin e aftësive të rëndësishme në epokën digjitale. Rezultatet e PISA jo vetëm që tregojnë pozicionin e vendit në krahasim me standardet ndërkombëtare, por gjithashtu ofrojnë udhëzime të vlefshme për përmirësimin e praktikave mësimore dhe avancimin e strategjive arsimore për të ardhmen.

Matura shtetërore dhe shkollore

Në fund të arsimit të mesëm, nxënësit përballen me provimet përfundimtare që përmbyllin shkollimin e tyre të mesëm dhe përbëjnë bazën për hapat e ardhshëm arsimorë dhe profesionalë:

- *Matura shtetërore*: Provim që është parakusht për vazhdimin e arsimit të lartë. Zakonisht përfshin gjuhën amtare, matematikën ose një gjuhë të huaj, si dhe lëndë të zgjedhura shpesh që korrespondojnë me interesat akademike të nxënësve.
- *Matura shkollore*: Për nxënësit që nuk vazhdojnë studimet në universitet, matura shkollore përmbyll arsimin e mesëm, duke u mundësuar atyre të fillojnë rrugën e tyre profesionale.

Aspektet individuale të këtyre provimeve, si zgjedhja e lëndëve, struktura dhe kriteret e vlerësimit, përcaktohen në Konceptin për dhënien e maturës. Këto provime përfundimtare përmbyllin tërësinë e arsimit të mesëm dhe garantojnë përgatitjen e nxënësve për sfidat e ardhshme. Rezultatet e provimeve përfundimtare ofrojnë informacion mbi suksesin e procesit arsimor dhe përdoren si tregues për dobësitë e sistemit që duhet të korrigjohen për gjeneratat e ardhshme të nxënësve të shkollave të mesme.

Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se gjimnazi është një mjedis akademik, ku qëllimi kryesor është përgatitja e nxënësve për vazhdimin e arsimit në nivel të lartë. Në këtë kontekst, matura shtetërore nuk duhet perceptuar si një nga dy opsionet, por si përfundim natyror i arsimit akademik dhe një hap logjik drejt universitetit. Nga vetë koncepti i arsimit të mesëm rezulton se të gjithë nxënësit duhet të synojnë arritjen e arsimit të lartë, ndërsa matura shkollore mbetet një përjashtim, e rezervuar për rastet specifike kur nxënësit, për arsye personale ose profesionale, nuk vazhdojnë arsimin formal. Kështu afirmohet roli i gjimnazit si institucion arsimor që jo vetëm siguron njohuri të përgjithshme, por krijon edhe një bazë intelektuale për realizim të mëtijshëm akademik dhe profesional.

Vlerësimi (evaluimi) dhe vetëvlerësimi i shkollave

Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i shkollave përbëjnë mjete kyçe për sigurimin dhe ruajtjen e cilësisë në arsimin e mesëm. Këto procese jo vetëm që ofrojnë një pasqyrë mbi gjendjen aktuale të shkollës, por ndihmojnë edhe në planifikimin e zhvillimit dhe përmirësimit të ardhshëm.

Vlerësimi integral zbatohet nga Inspektorati Shtetëror Arsimor (ISHA), duke përdorur procedura të standardizuara për mbledhjen e të dhënave mbi cilësinë e punës së shkollave. Ai mbulon disa fusha kryesore, si: organizimi dhe realizimi i mësimdhënies, kushtet dhe kultura në institucionet arsimore, menaxhimi, përmbushja dhe vlerësimi i detyrave të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë, zhvillimi profesional i stafit arsimor dhe drejtuesve, komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun, bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin dhe fusha të ngjashme.

Pas përfundimit të vlerësimit, shkollat marrin një raport të detajuar me gjetje dhe rekomandime për përmirësim. Këto raporte shërbejnë si bazë për planifikimin e investimeve, përmirësimin e menaxhimit dhe zhvillimin e inovacioneve në mësimdhënie. Përveç kësaj, raportet vjetore të ISHA ofrojnë një pasqyrë mbi cilësinë e procesit arsimor në nivel kombëtar, duke ndihmuar në krijimin e politikave arsimore.

Vetëvlerësimi i shkollave është një proces sistematik përmes të cilit shkollat marrin informacione të pasqyruara mbi punën e tyre. Të dhënat mblidhen nga të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë – nxënësit, mësimdhënësit, prindërit dhe komuniteti lokal. Fushat e vetëvlerësimit përputhen me ato të vlerësimit integral, duke mundësuar analizë krahasuese dhe vazhdimësi në procesin e përmirësimit.

Rezultatet e vetëvlerësimit u ndihmojnë shkollave:

- të njohin pikat e forta dhe sfidat;
- të planifikojnë aktivitete për tejkalimin e dobësive;
- të integrojnë gjetjet në planet e zhvillimit.

Këto rezultate, në kombinim me udhëzimet e vlerësimit integral, testimet shtetërore dhe ndërkombëtare, si dhe mbështetjen këshilluese nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit, krijojnë një bazë të fortë për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Përmbledhje e përfitimeve kryesore nga ndjekja e cilësisë së arsimit të mesëm

- **Përmirësimi i mësimdhënies dhe të nxënësve:** Nxiti një mësim efektiv dhe interaktiv që mbështet nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të mendojnë në mënyrë kritike.
- **Mbështetje për nxënësit:** Vlerësimi dhe vetëvlerësimi mundësojnë identifikimin e dobësive dhe planifikimin e aktiviteteve për t'i tejkaluar ato.
- **Zhvillimi i vazhdueshëm i shkollave:** Vlerësimi integral dhe vetëvlerësimi krijojnë bazën për plane zhvillimore dhe përmirësimin e menaxhimit dhe praktikave mësimore.
- **Përgatitja për sfidat e ardhshme:** PISA dhe provimet përfundimtare (matura shtetërore dhe shkollë) krijojnë një bazë të mirë për përgatitjen akademike dhe profesionale të nxënësve dhe mundësojnë identifikimin e dobësive që duhet tejkaluar për gjeneratat e ardhshme.
- **Transparenca dhe llogaridhënia:** Procedurat e standardizuara për vlerësim dhe monitorimin e cilësisë sigurojnë objektivitet dhe qartësi për të gjithë pjesëmarrësit në procesin arsimor.

KUADRI MËSIMOR, BASHKËPUNËTORËT PROFESIONALË DHE DREJTORËT

Kompetencat profesionale në arsimin e mesëm

Cilësia e procesit arsimor në gjimnazet lidhet ngushtë me kompetencat profesionale të mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe drejtorëve. Këto kompetenca përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme për realizimin efektiv të qëllimeve arsimore. Njohuritë lidhen me kuptimin e arsimit si sistem dhe njohjen e fushave specifike të lëndëve, ndërsa aftësitë dhe kapacitetet lidhen me zbatimin e tyre praktik.

Mësimdhënësit kompetentë njohin përgjegjësinë e tyre për suksesin e çdo nxënësi, duke u udhëhequr nga vlera që promovojnë përfshirjen, respektimin e të drejtave të njeriut dhe pranimin aktiv të ndryshimeve. Ata janë modele për nxënësit, jo vetëm brenda klasës, por edhe në mjedisin më të gjerë shkollor, duke forcuar kështu rolin e gjimnazit si një nyjë kyçe në procesin arsimor.

Roli i drejtorëve në gjimnaze

Drejtori është figura kryesore në organizimin dhe zhvillimin e gjimnazit. Kompetencat e tij/saj përfshijnë aftësi për menaxhim, zgjidhje problemesh dhe krijimin e një klime pune që nxit realizimin e suksesshëm të mësimdhënies. Drejtorët përgatiten për rolin e tyre përmes trajnimeve të veçanta dhe kalimit të provimit për drejtorë, çka konfirmon aftësinë e tyre për menaxhim efektiv. Ata inkurajojnë bashkëpunimin midis mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë, nxënësve dhe prindërve, duke krijuar një mjedis ku çdo pjesëmarrës në procesin arsimor ndihet i vlerësuar dhe i pranuar. Për më tepër, drejtuesit punojnë aktivisht për zhvillimin e partneriteteve me komunitetin lokal dhe sektorin privat për sigurimin e burimeve shtesë që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies dhe aktiviteteve jashtëshkollore.

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional

Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë fitojnë kompetencat themelore gjatë arsimit të tyre fillestar, ndërsa më pas i zhvillojnë më tej përmes praktikës së vazhdueshme dhe përgatitjes profesionale. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është e drejtë dhe detyrë për të gjithë mësuesit, bashkëpunëtorët profesionalë dhe drejtorët në arsimin e mesëm. Ai synon përmirësimin e njohurive dhe aftësive në përputhje me zbulimet më të fundit shkencore dhe tendencat bashkëkohore në arsim. Kompetencat e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë nuk janë statike – ato zhvillohen vazhdimisht për t'iu përgjigjur sfidave të reja arsimore dhe nevojave të nxënësve. Zhvillimi profesional mund të nisët individualisht nga mësimdhënësi/bashkëpunëtori profesional, bazuar në nevojat personale, por edhe në mënyrë sistematike, përmes aktiviteteve të propozuara nga institucionet kombëtare arsimore. Këto aktivitete përfshijnë trajnime të akredituara, uebinare, konferenca dhe bashkëpunime ndërkombëtare, të cilat ofrojnë mundësi për shkëmbim përvojash dhe për futjen e praktikave inovative në mësimdhënie.

Në gjimnaze formohen grupe për zhvillim profesional që kanë për detyrë të identifikojnë nevojat e mësimdhënësve dhe të koordinojnë (bashkërendisin) trajnimet dhe aktivitetet, duke përdorur burime të brendshme dhe të jashtme.

Bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve

Bashkëpunimi është themeli për realizimin e suksesshëm të procesit arsimor në gjimnaz. Aktivitetet shkollore dhe komunitetet profesionale të të nxënës përbëjnë një forum ku mësimdhënësit ndajnë përvojat, diskutojnë për sfidat dhe zhvillojnë së bashku strategji për përmirësimin e mësimdhënies. Këto grupe mund të organizohen sipas lëndëve ose temave më të gjera, duke përfshirë bashkëpunëtorët profesionalë, tutorët dhe subjekte të tjerë të përfshirë. Mësimdhënësit mund të bashkëpunojnë edhe në mënyrë virtuale, përmes platformave për shkëmbimin e materialeve, diskutime dhe blogje profesionale. Këto mjete janë të dobishme jo vetëm për mësimdhënësit më pak me përvojë, por edhe për ata më me përvojë, të cilët kanë mundësinë të pasurojnë repertorin e tyre të metodave dhe qasjeve. Bashkëpunimi promovon ndjenjën e përkatësisë dhe komunitetit, që është kyçe për cilësinë e mësimdhënies dhe motivimin e të gjithë pjesëmarrësve në procesin arsimor.

Zhvillimi i karrierës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë

Zhvillimi i karrierës së mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë bazohet në standardet profesionale dhe përfshin avancimin në tituj, si mentor dhe këshilltar. Për të arritur këto nivele, është e nevojshme të përmbushen kriteret e përcaktuara me aktet ligjore, të cilat përfshijnë standarde të

larta pune, zhvillim profesional të vazhdueshëm dhe pjesëmarrje në zhvillimin e materialeve dhe praktikave mësimore.

Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë që avancojnë me sukses kontribuojnë jo vetëm në përmirësimin e punës së tyre, por edhe në mbështetjen e kolegëve, nxënësve dhe shkollës në tërësi. Kjo forcon rolin e gjimnazit si institucion që përgatit nxënësit për një të ardhme të suksesshme. Me këtë qasje, gjimnazet vendosin bazat për zhvillimin e një arsimi cilësor që i përgatit nxënësit për sfidat bashkëkohore dhe mbështet mësimdhënësit dhe drejtorët në rolet e tyre profesionale.

Përmbledhje e përfitimeve kryesore nga zhvillimi profesional dhe karrierës së mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe drejtorëve

- **Menaxhim efektiv i shkollave** – Drejtorët menaxhojnë me sukses shkollën, inkurajojnë bashkëpunim në grup dhe sigurojnë burime shtesë përmes partneriteteve me komunitetin dhe sektorin privat.
- **Zhvillim profesional i vazhdueshëm** – Siguron përmirësim të vazhdueshëm të stafit mësimor dhe bashkëpunëtorëve profesionalë përmes trajnimeve, uebinarëve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare, duke kontribuar në një cilësi më të lartë të mësimdhënies.
- **Kompetenca profesionale të harmonizuara të mësimdhënësve** – Mësimdhënësit zotërojnë njohuritë e nevojshme për fushën e lëndës dhe sistemin arsimor, janë të aftë në zbatimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe nxisin aktivisht përfshirjen dhe respektimin e diversitetit gjatë mësimin.
- **Bashkëpunim i përmirësuar ndërmjet mësimdhënësve** – Përmes aktiviteteve shkollore dhe komuniteteve profesionale të të nxënësve, mësimdhënësit shkëmbejnë përvoja dhe zhvillojnë strategji inovative për përmirësimin e procesit arsimor.

KLIMA DHE KULTURA SHKOLLORE NË GJIMNAZE

Krijimi i një kulture shkollore që nxit nxënësit për të mësuar dhe për zhvillim personal është thelbësor për sigurimin e një arsimi cilësor. Është e qartë për të gjithë se nxënësit nuk mësojnë vetëm nga përmbajtjet mësimore të orëve, por edhe nga mesazhet e fshehura që marrin nga i gjithë mjedisi shkollor. Këto mesazhe vijnë nga mënyra se si është organizuar dhe drejtuar shkolla, nga cilësia e marrëdhënieve midis mësimdhënësve, nxënësve dhe punonjësve të tjerë, nga marrëdhënia me prindërit, nga rregullat dhe traditat e gjimnazit, si dhe nga pamja dhe funksionaliteti i ambienteve shkollore.

Prandaj, gjimnazet përpiqen që mesazhet që nxënësit marrin gjatë mësimin të reflektohen dhe të forcohen përmes të gjithë ambientit shkollor, duke krijuar bazën për zhvillimin e qëndrimeve dhe vlerave pozitive tek të rinjtë.

Ndërtimi i një kulture pozitive shkollore kontribuon në përmirësimin e rezultateve akademike dhe sociale të nxënësve. Kur shkolla funksionon si një komunitet mbështetës, nxënësit kanë më shumë motivim për të mësuar, zhvillojnë marrëdhënie më të mira ndërpersonale dhe krijojnë vlera që do t'i udhëheqin gjatë gjithë jetës. Në këtë mënyrë, gjimnazet jo vetëm që përgatisin nxënësit për fazat e ardhshme të zhvillimit të tyre arsimor dhe profesional, por gjithashtu kontribuojnë në formimin e qytetarëve të përgjegjshëm dhe të vetëdijshëm.

Klima inkurajuese shkollore

Gjimnazet krijojnë një klimë shkollore nxitëse përmes një vizioni të qartë për arsimin, rolin e shkollës në realizimin e këtij vizioni dhe vlerave të përbashkëta që promovojnë. Për të siguruar një atmosferë pozitive të përgjithshme, shkollat i përkushtohen përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve fizike, furnizimit me burime dhe sigurimit të një mjedisi të sigurt, të lirë nga diskriminimi dhe dhuna.

Një aspekt kryesor i kësaj klime është respektimi i të gjithë aktorëve në shkollë – nxënësve, mësimitdhënësve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe stafit administrativ. Kjo arrihet përmes një qasjeje demokratike në menaxhim, që përfshin transparencë në vendosjen e rregullave të sjelljes, qarkullim të rregullt të informacionit dhe pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve në procesin vendimmarrës.

Gjimnazi është një mjedis që nxënësit e perceptojnë si një hapësirë inspiruese për zhvillim personal dhe social, ku nuk vlerësohet vetëm njohuria, por edhe kreativiteti, angazhimi, talenti dhe shprehja individuale. Në këtë fazë të jetës, kur nxënësit formojnë qëndrime, interesa dhe identitet, shkolla duhet të ofrojë mundësi të ndryshme që i mbështesin ata jo vetëm akademikisht, por edhe në të gjitha aspektet e tjera të zhvillimit të tyre.

Gjimnazet organizojnë, brenda shkollës dhe ndërmjet tyre, gara në lëndë të ndryshme, konkurse letrare dhe artistike, shfaqje teatrale shkollore, grupe muzikore dhe ekipe sportive që u mundësojnë nxënësve të shprehen, të bashkëpunojnë dhe të garojnë në një frymë pozitive. Këto aktivitete jo vetëm që rrisin ndjenjën e përkatësisë ndaj shkollës, por edhe zhvillojnë vetëbesimin, aftësitë udhëheqëse dhe kapacitetin për punë në grup.

Veçanërisht të rëndësishme janë mundësitë për bashkëpunim me shkolla nga qytete dhe shtete të tjera përmes projekteve, shkëmbimit të nxënësve dhe iniciativave të përbashkëta. Në këtë mënyrë, nxënësit fitojnë përvojë ndërkulturore, zhvillojnë vlera europiane dhe zgjerojnë perspektivën e tyre mbi botën. Një klimë e tillë nxitëse i përgatit të rinjtë jo vetëm për sukses akademik, por edhe për një qytetari aktive, të përgjegjshme dhe të angazhuar.

Roli i organizimit të nxënësit

Gjimnazet nxisin organizimin aktiv të nxënësve përmes strukturave të ndryshme, si komunitetet klasore, parlamenti shkollor dhe forma të tjera të shoqërimeve të nxënësve. Këto struktura u mundësojnë nxënësve të jenë pjesëmarrës aktivë në zgjidhjen e problemeve të tyre dhe të shkollës. Përmes këtyre organeve, nxënësit mësojnë të marrin vendime, të nisin iniciativa dhe të kujdesen për përmirësimin e ambientit shkollor.

Përfitimet nga organizimi i nxënësve janë të shumta. Së pari, nxënësit zhvillojnë aftësi udhëheqëse dhe ndjenjë përgjegjësie. Së dyti, krijohet një kulturë dialogu, pune në grup dhe respektimi i mendimeve të ndryshme. Së treti, këto aktivitete i përgatisin nxënësit për një rol aktiv qytetar në shoqëri. Për më tepër, organizimi i nxënësve krijon një mjedis ku ata ndihen të dëgjuar dhe të vlerësuar, çka rrit motivimin e tyre për të mësuar dhe forcon pjesëmarrjen e tyre në jetën e shkollës.

Roli i mësimdhënies

Në gjimnaze, mësimdhënia është e dizajnuar të jetë interaktive, e përshtatur me nevojat dhe interesat e nxënësve dhe e fokusuar në nxitjen e pjesëmarrjes aktive. Mësimdhënësit shihen më shumë si partnerë në procesin e të nxënësve sesa si autoritete. Ata përpiqen të krijojnë një mjedis ku nxënësit ndihen të vlerësuar për idetë dhe opinionet e tyre.

Për të mundur që mësimdhënësit të kryejnë me sukses këtë rol, gjimnazet investojnë në zhvillimin e tyre profesional të vazhdueshëm përmes trajnimeve dhe mundësive për përmirësim. Për më tepër, u kushtohet vëmendje avancimit të tyre në karrierë, shpërblimit për arritjet dhe mbështetjes për ruajtjen e një statusi të lartë profesional dhe shoqëror.

Bashkëpunimi me prindërit dhe bashkësinë vendore

Bashkëpunimi me prindërit është një pjesë e rëndësishme e kulturës shkollore në gjimnaz. Prindërit përfshihen në aktivitete të ndryshme, nga pjesëmarrja në këshillin e prindërve dhe shkollës, deri te vullnetarizmi në ngjarje, ligjërata dhe aktivitete të përbashkëta me fëmijët e tyre. Ky lloj partneriteti kontribuon në krijimin e një lidhjeje të fortë midis shkollës dhe familjes, që ka një ndikim pozitiv mbi suksesin e nxënësve.

Komuniteti lokal gjithashtu luan një rol të rëndësishëm. Gjimnazet bashkëpunojnë me institucionet lokale për të siguruar mbështetje shtesë për aktivitetet e tyre. Në këmbim, nxënësit dhe mësuesit marrin pjesë aktivisht në aktivitete humanitare, ekologjike dhe të tjera, të cilat forcojnë lidhjen midis shkollës dhe komunitetit. Për më tepër, gjimnazet shpesh lidhen me shkolla të tjera në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, gjë që mundëson shkëmbimin e përvojave dhe ideve për përmirësimin e proceseve arsimore.

Përmbledhje e përfitimeve kryesore të kulturës shkollore sipas konceptit të parashikuar

- **Klimë shkollore nxitëse:** Krijon një atmosferë pozitive përmes një vizioni të qartë, një mjedisi të sigurt dhe menaxhimi demokratik.
- **Organizimi i nxënësve:** Zhvillon aftësi udhëheqëse, përgjegjësi dhe kulturë pune në grup dhe kulturë dialogu.
- **Mësimdhënie interaktive:** Nxit pjesëmarrje aktive, mendim kritik dhe marrëdhënie partneriteti midis mësimdhënësve dhe nxënësve.
- **Bashkëpunim me prindërit:** Ndërton një lidhje të fortë midis shkollës dhe familjes për përmirësimin e suksesit të nxënësve.
- **Angazhim me komunitetin lokal:** Siguron mbështetje shtesë për aktivitetet jashtëmësimore dhe forcon marrëdhënien midis shkollës dhe komunitetit.
- **Zhvillimi i vlerave:** Kontribuon në përparim akademik dhe social, duke formuar qytetarë të përgjegjshëm dhe të vetëdijshëm.

